

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZA-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.R. nga fshati ..... komuna e Shtimes, për shkak të veprës penale Asgjësim, dëmtim ose heqje e instalimeve publike nga neni 336 par.1 me par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/Inr.1940-8/15 të dt.17.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datën 04.03.2016, në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani , përfaqësuesi i KEDS-it Skender Musa dhe i akuzuari, të njëjtën ditë shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari R.R. nga fshati ..... komuna e Shtimes, data e lindës..... në ....., nga i ati M. e ëma E., e gjinisë B., shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, punon në .....,i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike,i pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri.

Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 85 dhe 86 të KPRK-së dhe neneve 498, 499 dhe 500 të KPPK-së, të akuzuarit **R.R.** i shqipton:

### VËREJTJE GJYQËSORE

Sepse me dt.02.09.2015, rrethë orës 17:00, në rrugën “Ismajl Qemajli” në Shtime i dyshuari R.R. duke drejtuar kamionin transportues-mikser të betonit te tipi Volvo FL10 me targa ....., nga pakujdesia i ka dëmtuar përçuesit e rrymës elektrike duke shkaktuar edhe dëme materiale edhe rrjetit elektrik.

-me të cilën ka kryer veprën penale Asgjësim, dëmtim ose heqje e instalimeve publike nga neni 366 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së.

E dëmtuara përfaqësuesi i KEDS-it zyra në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale-paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të gjitha nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/Inr.1940-8/15 të dt.17.12.2015 ka ngarkuar të akuzuarit R.R. nga fshati ..... komuna e Shtimes, me të cilën kreu veprën penale vjedhje nga nen. 325 par.1 të KPRK-së.

Në gjykatë i akuzuari me dt.29.02.2016 është paraqitur pa ftesë dhe ka kërkuar nga gjyqtari i ngarkuar në këtë lëndë penale që ti mundësohet mbajtja sa më par e shqyrtimit fillestar për veprën për të cilën akuzohet, meqë është duke punuar përkohësisht në ..... e së shpejti ka një intervistë për vazhdimin e kontratës së punës, ku Gjyqtari gjykues e ka ftuar që të paraqitet në gjykatë me dt.04.03.2016, ku me kohë është paraqitur i akuzuari dhe prokurori i shtetit, Ismet Rrahmani.

Në fillim të shqyrtimit fillestara i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dërguarit e të akuzuarit janë rrespektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

Përkitazi me këtë i akuzuari R.R., e ka pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohet dhe në vazhdim ka theksuar se është e vërtetë se ditën kritike gjersa kam qen duke vozitur kamionin-mikserin e betonit nuk e ka vërejtur fare telin e rrymës dhe e kishte goditur me mikserin e kamionit, pastak ka vazhduar rrugën duke mos e ditur se çka i ka ndodhur, e për këtë është njofutar nga ana e policisë që të lajmrohet tek ato dhe është njëftuar për çka është ftuar ku dhe për këtë ka dhënë deklaratë me shkrim. E njofton përfaqësuesin e KEDS-it zyra në Ferizaj se dëmi nuk është i precizuar por në qoftë se precizohet është i gatshëm që ta kompenzoj, është përnduar për veprën e kryer dhe i ka propozuar gjykatës që ti shqipton një dënim më të butë.

Gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe i ka propozuar gjykatës që për veprën penale që i vehet në barrë të akuzuarit ti shqipton vërejtje gjyqësore.

Përfaqësuesi i KEDS-it Skender Musa në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se i bashkangjitet njëkjes penale kundër të akuzuarit dhe mbetet pran kërkesës pasuroro-juridike ku këtë do ta kërkon pas precizimit të saj.

Gjykata duke i vlerësuar veprimet e të akuzuarit në aspektin juridik gjeti se në verimet e tij qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale -me të cilën ka kryer veprën penale Asgjësim, dëmtim ose heqje e instalimeve publike nga neni 366 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së, por gjykata pasi analizoj të gjitha faktet e kësaj çështje penale, provave që gjinden në shkresat e lëndë ka aplikuar dispozitat ligjore të neneve 85, 86 të KPRK-së dhe neneve 498, 499 dhe 500 të KPPK-së dhe të akuzuarit R.R. i ka shiptuar sanksionin penale vërejtje gjyqësore, duke pas parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën e kryer e në rasin konkret gjykata mendon se ky sanksion penal është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore kryesit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikëshme që përbën vepër penale dhe nese kryesi prap kryen veprime të tilla gjykata do ti shqiptoj sanksion ma të rëndë penal.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së , të dëmtuarës: përfaqësuesi i KEDS-it zyra në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi e paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P.nr.1610/2015 datë 04.03.2016**

**Asistenti**  
Muedin Rexhepi

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa  
në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit  
Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate